



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 284, datë 10.12.2019

PËR

SKUALIFIKIMIN E KANDIDATES JOGJYQTARE ZNJ. {...} DHE PËRJASHTIMIN E SAJ NGA KANDIDIMI PËR EMËRIM SI GJYQTARE NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 10.12.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatorja, znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës znj. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

I. *Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative.*

II. Afati i kandidimit

1. *Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

1.1 Me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr.

98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:**

I. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.

II. Afati i kandidimit

2. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. **Brenda afatit** dyjavor nga nga dita e publikimit të dy vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **për dy pozicionet e lira** të shpalluara përmes vendimeve të mësipërme, **ka aplikuar për të marrë pjesë edhe kandidatja znj. {...}**.

3. **Me Vendimin nr. 142, datë 26.07.2019**, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :**

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, konkretisht për znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu; ...”.

4. **Më datë 26.07.2019**, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **kandidatja, znj. {...}**, në rrugë elektronike, **u njoftua :**

- **për fillimin e procedurës së verifikimit** të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit;
- **për caktimin e relatorit** të kësaj procedure verifikimi;
- **për të të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit**, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për **plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit** ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidatja znj. {...}, **depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik**, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj.

Nga ana tjetër, në këtë afat, **kandidatja nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

6. **Më datë 26.07.2019**, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion nuk ishte i plotë, **kandidatja znj. {...}**, në rrugë

elektronike, **u njoftua për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit**, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. **Po më datë 29.07.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates znj. {...}, në rrugë elektronike, **iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse** (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesë ditor, **kandidatja znj. {...}, depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit**, ndërsa brenda datës 06.09.2019 të caktuar me Vendimin nr. 142, datë 26.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ajo dorëzoi rregullisht edhe **formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave** (më poshtë referuar si ILDKPKI).

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, **në datat 06.08.2019 dhe 07.08.2019**, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, **u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për znj. {...}**.

10. **Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme.**

11. **Më datë 06.08.2019**, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, asaj *“të pasjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me Shkresën nr. 4163 prot., **u kërkua informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin e gradës shkencore në drejtësi nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër ta edhe për znj. {...}**.

12. **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar informacionin dhe konfirmimin përkatës, ndër të tjerë edhe për kandidaten znj. {...}, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019**, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4163/1 prot., datë 26.08.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

13. **Po më datë 06.08.2019**, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit *“të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, por edhe të kriterit *“të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, neni 49 në lidhje me shkronjë “dh” të nenit 28, të Ligjit të Statusit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, **u kërkua informacion nga subjektet shtetërore dhe private që kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidates znj. {...}, subjekte**

të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor **informacionet e tyre në kohë të ndryshme** (siç do të përkruhet më poshtë).

14. Po në kuadër të verifikimit të kushtit dhe kriterit të kandidimit si më lart (sipas pikës 13), **më datë 06.08.2019, u kërkua informacion në lidhje me punësimin e kandidatëve, ndër ta edhe për znj.{...}, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilët kanë përcjellë** për Këshillin e Lartë Gjyqësor **informacionet e tyre në kohë të ndryshme** (siç do të përkruhet më poshtë).

15. Në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit **“të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”**, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, **u kërkua informacion nga gjykata e regjistrit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sa i përket kandidatës znj.{...} ka përcjellë informacionin e saj më datë 25.10.2019** (siç do të përkruhet më poshtë).

16. Në vijim të verifikimit, në lidhje me kriterin e pasjes së zotësisë për të vepruar, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga gjykata e vendbanimit të kandidatës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, të **cilat kanë përcjellë informacion më datë 28.10.2019 dhe datë 30.10.2019** (siç do të përkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË

1. **Kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 136, pikat 3 dhe 4.** Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, **“3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi. 4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”**.

2. Po ashtu, **kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, janë përcaktuar edhe në Ligjin e Statusit, nenin 49 (“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”), pikat 1 dhe 2, shkronja “b”.** Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, **“1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. 2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”**.

3. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikuan këto kushte kandidimi/emërimi:

a) qënia jurist.

a.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar (të njësuar me origjinalin) dokumentacionin:

Diplomë nr. 4088, me nr. regjistri 2405, lëshuar më datë 06.07.1996, nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidatja {...}, në periudhën 1992 - 1996, ka kryer kursin e plotë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në Degën “Drejtësi” dhe **me vendim të komisionit shtetëror të datës 06.07.1996 i është dhënë titulli “Jurist”**. Bashkëngjitur Diplomës është dhe dokumenti (i njësuar me origjinalin) “Lista e Rezultateve të Provimeve”, lëshuar më datë 28.02.2019, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

b) përvoja profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

b.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentacion, sipas të cilit kandidatja ka përvojë profesionale si vijon:

nga viti 1997 – 1998 juriste pranë Departamentit Ligjor në Ministrinë e Financave;

nga viti 1998 – 2001 juriste pranë Agjencisë për Zhvillim Ekonomik (AEDA), në Ministrinë e Ekonomisë;

nga viti 2002 – 2003 pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;

nga viti 2001 – 2010 juriste/avokate pranë DIEKAT Group;

nga viti 2003 e në vijim Avokat, anëtar i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë;

nga viti 2008 – 2010 pedagoge pranë Universitetit Amerikan në Tiranë;

nga viti 2010 – 2018 drejtore ekzekutive e Institutit të Qeverisjes së Korporatave të Shqipërisë CGIA;

nga viti 2010 e në vazhdim avokate/drejtore juridike & Përputhshmërisë dhe Burimeve Njerëzore në Hellas Group (ENERGIA B, HELLAS, EVROIL);

nga viti 2016 e në vazhdim avokate pranë R & T Consulting Company – Partner & CEO;

nga viti 2016 e në vazhdim anëtare e Bordit/Corporate Governance Institute – Albania;

b.2 Gjatë verifikimit, referuar subjekteve ku kandidatja figuronte të kishte qenë e punësuar sipas dokumentacionit të paraqitur, prej tyre u kërkua informacion për të dhënat e punësimit të kandidatës. Konkretisht, :

- ❖ me Shkresën nr. 14852/1 prot., datë 14.08.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë informon se kandidatja: *“ka punuar specialist në Drejtorinë e Legjislacionit pranë Ministrisë së Financave nga data 22.04.1997 – 30.04.1998 dhe është larguar nga puna me shkresën nr. 2103 datë 27.04.1998 me masë disiplinore “për kryerje pa shkaqe të pranueshme të veprimit, përdorimin e kompetencave e paautorizuar nga dikasteri”*”.
- ❖ me Shkresën nr. 028 prot., datë 13.08.2019, Shoqëria EVROIL sh.a Tiranë informon se kandidatja: *“ka punuar Juriste/Këshilltare Juridike dhe më pas Avokate pranë Shoqërisë*

EVROIL sh.a nga data 01.04.2001 dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me të si avokate e grupit të kompanive të kontrolluara nga një aksioner që ishte DIEKAT ATE nëpërmjet degës së saj në Shqipëri DIEKAT Ndërtim & Konstruksiione sh.a e cila aktualisht është e përthithur nga Kompania ENERGIA B sh.p.k, vijojejnë akoma.... Ndaj saj nuk ka patur asnjëherë masë disiplinore”

- ❖ me Shkresën e datës 07.11.2019, Shoqëria ENERGIA B sh.p.k Tiranë informon se kandidatja: *“ka punuar si Avokate pranë Shoqërisë nga data 01.05.2016 – 31.08.2019 dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me të si avokate e grupit të kompanive të kontrolluara nga një aksioner që ishte DIEKAT ATE nëpërmjet degës së saj në Shqipëri DIEKAT Ndërtim & Konstruksiione sh.a e cila aktualisht është e përthithur nga Kompania ENERGIA B sh.p.k, kanë filluar që nga data 01.04.2001 deri më 30.04.2016 dhe vijojejnë akoma si avokate e jashtme.... Ndaj saj nuk ka patur asnjëherë masë disiplinore, është dalluar për korrektësi, profesionalizë, dhe etikë të lartë profesionale*”
- ❖ me Shkresën e datës 11.11.2019, Shoqëria SISHP sh.p.k Tiranë informon se kandidatja: *“ka qenë një nga ortakët themelues të shoqërisë e cila është regjistruar si sh.p.k pranë QKB-së me datë 25.08.2011 deri me datë 25.04.2014 kur ajo ka shitur aksionet e saj në këtë kompani. Që nga themelimi kandidatja ka qenë administrator e shoqërisë deri sa është larguar me dëshirën e saj duke dhënë një kontribut të veçantë*”
- ❖ me Shkresën e datës 11.11.2019, Shoqëria R&T Consulence sh.p.k Tiranë informon se kandidatja: *“ka qenë një nga ortakët themelues të shoqërisë e cila është regjistruar si sh.p.k pranë QKB-së me datë 18.01.2016 dhe ka punuar si avokate. Që nga data 17.09.2018 kandidatja mban pozicionin e administtores së shoqërisë ...dhe nuk ka qenë asnjëherë pjesë e asnjë procedure disiplinore.....”*

b.3 Po ashtu, gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Konkretisht:

- me Shkresën nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, ndër të tjera, informon se : Shtetësja e sipërcituar rezulton të jetë administratore e subjektit “R&T Consulence”, i cili është me status aktiv që në datë 18.01.2016. Gjithashtu rezulton të jetë administratore e subjektit “{...}”, i cili është me status pasiv që në datë 03.02.2016. *“Për shtetasen {...}... për efekt burim të ardhura nga paga, rezulton të ketë punuar ose/dhe punon pranë subjektit: 1. Diekat Ndërtim & Konstruksiione – juriste 2. Energia B – juriste 3. {...} me nipt K72204011Q – avokate 4. Corporate Governance Instituti-Albania-president organizate 5. SISHP – analiste menaxhimi 6. R&T Consulence-Eksperte vlerësimi për sigurimet”*. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar dhe një kopje-historiku i punësimit sipas ESIG027, kopje-ekstrakti historik i punonjësit, me të gjithë të dhënat shifrore të pagës, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, kontributet përkatëse dhe TAP për çdo muaj, vit dhe subjekt/institucion punëdhënës, në të cilin ka punuar dhe/ose punon kandidatja.
- me Shkresën nr. 5744/1 prot., datë 09.08.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon për të dhëna punësimi të kandidatit për periudhën janar 2012 e në vijim, referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi informatik i saj, që dispononte të dhëna për kontributet që

mblidheshin dhe dërgoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet WebService, të dhëna këto që disponoheshin nga viti 2012 dhe në vijim. Sipas të dhënave të dërguara përmes kësaj shkrese, jepen të njëjta të dhëna punësimi të kandidatës sikundër ato të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si më lart;

- me Shkresën nr. 8468 prot., datë 17.09.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, informon për të dhënat e punësimit të kandidatit për periudhën 1994¹ - 2012, si vijon: i punësuar pranë Ministrisë së Financave për periudhën maj 1997 – prill 1998; pranë Subjektit AEDA – Agjensia e Zhvillimit Ekonomik për periudhën tetor 1998 – mars 2001; pranë Subjektit DIEKAT NDËRTIM & KONSTRUKSION sh.a për periudhën maj 2002 – dhjetor 2005, janar 2006 – dhjetor 2009, janar 2010 – dhjetor 2012;

b.4 Sipas të dhënave të grumbulluara, kandidatja {...} del të ketë përvojë profesionale deri në momentin e kandidimit si vijon: si avokate mbi 15 vjet dhe juriste mbi 5 vjet.

Në total, kandidatja ka përvojë profesionale mbi 20 vjet e ndër to, me kohë të plotë si avokat, përmbi 15 vjet.

c) pasja gradë shkencore në drejtësi.

c.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentat: - Diplomë Dokorate nr. 1548, me nr. Regjistri {...} lëshuar me datë 28.04.2017 nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidatja {...}, me Vendimin nr: 167, datë 03.10.2016 ka marrë gradën shkencore “doktor” dhe është vlerësuar “Shumë mirë”;

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila**, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, **informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se:**

“...10. Grada shkencore “Doktor” në “Civile/E drejta e Shoqërive Tregtare” e fituar nga znj. {...} figuron e regjistruar në regjistrin e KVTA-së për Gradën Shkencore: “Doktor” me numër rendor: {...}, Universiteti i Tiranës, Nr. Vendimi: {...}, datë 03.10.2016...”

Të gjitha gradat shkencore të listuara më sipër, përveç gradës shkencore të fituar nga ..., i përkasin fushës së drejtësisë”.

ç) mbajtja e funksioneve politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

ç.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 30.07.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se “nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

¹ Koha kur ka filluar zbatimi i Ligjit nr. 7703, date 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit, për përfitimin e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore, organet e sigurimeve shoqërore grumbullonin dokumentacionin për veprimtaritë ekonomike të të punësuarve dhe mblidhnin kontributet e paguara të sigurimeve shoqërore.

d) mbajtja e pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

d.1 Nga verifikimi i bërë, më datë 22.11.2019, nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), rezultoi se në këtë regjistër, me përbërës të gjendjes civile (emër, mbiemër) {...}.

d.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi u kërkua dhe u mor informacion nga gjykata e regjistrit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me Shkresën nr. 84-7/4 prot., datë 28.10.2019, sa i përket kandidates {...}, ka informuar se “Nga verifikimet e kryera në aktet e depozituara nga subjektet politike, në regjistrin e Partive Politike pranë kësaj gjykate nuk rezultoi që shtetasit ... {...}... të kenë qenë pjesë e organeve drejtuese të Partive Politike”.

III. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË

A. Për kriteret sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit

1. Disa nga kriteret e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Ligjin e Statusit, neni 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”.

1.1 Sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, “2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f", të nenit 28, të këtij ligji; ...”.

1.2 Ndërsa sipas nenit 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të Ligjit të Statusit, që parashikon kriteret e pranimit në formimin fillestar dhe bën pjesë në institutin e rekrutimit të kandidatëve magjistratë, “Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; ...; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; ...; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

2. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikuan këto kriteret kandidimi/emërimi:

a) zotësia e plotë për të vepruar.

a.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi u mbajt në konsideratë se “zotësia për të vepruar”, si kategori juridike që i takon individit, gjen rregullim në legjislacionin civil (Kodin Civil), ndërsa i njëjti kuptim për të konsiderohet edhe kur individ është subjekt i të drejtës publike. Zotësia për të vepruar nënkupton aftësinë e personit për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Zotësia për

të vepruar fitohet me arritjen e moshës 18 vjeç dhe, sipas ligjit, pasja e kësaj zotësie prezumohet deri në vërtetimin e heqjes apo kufizimit të saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

a.2 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidates, ajo del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Me Shkresën nr. 8407/2 prot., datë 25.10.2019 gjykata e vendbanimit të kandidatit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, informon se nga verifikimet e bëra nuk rezulton të jetë paraqitur kërkesë për heqjen e zotësisë për të vepruar për kandidaten {...}.

a.2.1 Me Shkresën nr. 2659 prot., datë 30.10.2019 Dhoma Kombëtare e Noterisë, informon se nga verifikimet e bëra nuk rezulton të jetë në listën e personave të cilëve ju është hequr zotësia për të vepruar, kandidatja {...}.

b) shtetësia shqiptare.

b.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Letërnjoftim”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 16.02.2009, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, konkretisht “shqiptare”.

b.2 Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidatë. Përkundrazi, nga çertifikata personale lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake nr. 5 Tiranë, më datë 31.07.2019, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare.

c) gjendja gjyqësore.

c.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentin “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”, me nr. 17 prot., datë 19.07.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit kandidatja figuron e padënuar penalisht.

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore), e cila, me Shkresën nr. V-2595/1 prot., datë 09.08.2019, ndër të tjera, informon se nga verifikimi i bërë në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Gjyqësore, kandidatja rezulton e padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

ç) disiplina në punë.

ç.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*gjatë karrierës time profesionale nuk jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk kam marrë dhe as nuk kam asnjë masë disiplinore*”.

ç.2 Gjithashtu, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar ndër të tjera një Vërtetim nr. 367 prot. datë 17.07.2019, lëshuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë me të cilin vërtetohet se kandidatja është mbajtëse e liçensës nr. {...} si anëtare e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe ushtron profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë prej vitit 2003 e në

vazhdim.....nuk ka detyrime financiare dhe në ngarkim të saj nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore në proces”;

ç.3 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga subjektet shtetërore dhe privatë, ku kandidatja ka punuar dhe punon aktualisht.

- Nga shkresa nr. 14852/1 prot., datë 14.08.2019 e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rezulton se kandidatja: *“ka punuar specialist në Drejtorinë e Legjislacionit pranë Ministrisë së Financave nga data 22.04.1997 – 30.04.1998 dhe është larguar nga puna me shkresën nr. 2103 datë 27.04.1998 me masë disiplinore “për kryerje pa shkaqe të pranueshme të veprimit, përdorimin e kompetencave e paautorizuar nga dikasteri”.*
- me Shkresën nr. 028 prot., datë 13.08.2019, Shoqëria EVROIL sh.a Tiranë informon se kandidatja: *“ka punuar Juriste/Këshilltare Juridike dhe më pas Avokate pranë Shoqërisë EVROIL sh.a nga data 01.04.2001 dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me të si avokate e grupit të kompanive të kontrolluara nga një aksioner që ishte DIEKAT ATE nëpërmjet degës së saj në Shqipëri DIEKAT Ndërtim & Konstruksiione sh.a e cila aktualisht është e përthithur nga Kompania ENERGIA B sh.p.k, vijojnë akoma.... Ndaj saj nuk ka patur asnjëherë masë disiplinore*”
- me Shkresën e datës 07.11.2019, Shoqëria ENERGIA B sh.p.k Tiranë informon se kandidatja: *“ka punuar si Avokate pranë Shoqërisë nga data 01.05.2016 – 31.08.2019 dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit me të si avokate e grupit të kompanive të kontrolluara nga një aksioner që ishte DIEKAT ATE nëpërmjet degës së saj në Shqipëri DIEKAT Ndërtim & Konstruksiione sh.a e cila aktualisht është e përthithur nga Kompania ENERGIA B sh.p.k, kanë filluar që nga data 01.04.2001 deri më 30.04.2016 dhe vijojnë akoma si avokate e jashtme.... Ndaj saj nuk ka patur asnjëherë masë disiplinore, është dalluar për korrektësi, profesionalizëm dhe etikë të lartë profesionale*”
- me Shkresën e datës 11.11.2019, Shoqëria SISHP sh.p.k Tiranë informon se kandidatja: *“ka qenë një nga ortakët themelues të shoqërisë e cila është regjistruar si sh.p.k pranë QKB-së me datë 25.08.2011 deri me datë 25.04.2014 kur ajo ka shitur aksionet e saj në këtë kompani. Që nga themelimi kandidatja ka qenë administrator e shoqërisë deri sa është larguar me dëshirën e saj duke dhënë një kontribut të veçantë*”
- me Shkresën e datës 11.11.2019, Shoqëria R&T Consulence sh.p.k Tiranë informon se kandidatja: *“ka qenë një nga ortakët themelues të shoqërisë e cila është regjistruar si sh.p.k pranë QKB-së me datë 18.01.2016 dhe ka punuar si avokate. Që nga data 17.09.2018 kandidatja mban pozicionin e administatores së shoqërisë ...dhe nuk ka qenë asnjëherë pjesë e asnjë procedure disiplinore.....”*

dh) qënia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

dh.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se *“nuk kam qenë dhe nuk jam bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.*

dh.2 Gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit edhe të kriterit të figurës së kandidates, u kërkua dhe u mor informacion nga shërbimet shtetërore informative, nga të cilat nuk u bë prezent ndonjë e dhënë për qënien e kandidates, bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete. duke konsideruar gjetje faktin e largimit nga puna për shkaqe disiplinore me urdhrin nr. 2103 prot, datë 27.04.1998 të Ministrit të Financave, vendosi të njoftojë kandidaten {...} për të dhënë shpjegime, për gjetjen e kësaj procedure në kuptim të nenit 49/2/a në lidhje me pikën “dh” të nenit 28 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit

1. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49² në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32³, të Ligjit të Statusit.
2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 103/25 prot., datë 09.10.2019.
3. Pas njohjes së kandidates më këtë Raport dhe paraqitjes nga ajo të sqarimeve dhe dokumentacionin mbështetës, u kërkua raportim shtesë nga ILDKPKI^{ja}, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin e datës 31.10.2019 dhe raportin e datës 20.11.2019.

² “5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.

³ “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të cilat kanë paraqitur pranë këshillit informacionin përkatës.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit

1. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkua dhe ajo plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 30.07.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

IV. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI I REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u njoh me relacionin përkatës të relatores së çështjes, si dhe materialet e grumbulluara gjatë verifikimit, marrë shkas nga gjetja e konstatuar nga relatorja e çështjes në lidhje me një nga kriteret e kandidimit të znj. {...}, me vendim të ndërmjetëm, për racionalitet dhe efektivitet, vendosi të shqyrtonte paraprakisht rezultatet e verifikimit vetëm sa i përkiste kushteve dhe kriterëve formale të kandidimit dhe, në varësi të kësaj, nëse konkludohej për përmbushjen e tyre nga kandidatja, të vijonte shqyrtimi edhe për kriteret e pasurisë dhe të figurës.

2. Në lidhje me kushtet dhe kriteret formale të kandidimit të znj. {...}, pas shqyrtimit të rezultateve të verifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush ato, me përjashtim të një prej kriterëve të kandidimit.

3. Konkretisht, gjatë procedurës së verifikimit është konstatuar si gjetje, që mund të passillte skualifikimin dhe përjashtimin e kandidates nga procedurat e emërimit ku ajo ka kandiduar, mosplotësimi nga ajo të kriterit **“nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”**, përcaktuar në nenin 28, gërma “dh”, të Ligjit për Statusin. Të dhënat konkrete të kandidates në lidhje me këtë kriter janë evidentuar në shkronjën “ç”, Kreu III, të këtij Vendimi.

4. Pwr kwtw shkak, në përputhje me Vendimin 75/2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, më datë 06.11.2019, bazuar në të dhënat e evidentuara në shkresën nr. 14852/1 prot., datë 14.08.2019, ku Ministria e Financave dhe Ekonomisë informon se kandidatja: **“ka punuar specialist në Drejtorinë e Legjislacionit pranë Ministrisë së Financave nga data 22.04.1997 – 30.04.1998 dhe është larguar nga puna me shkresën nr. 2103 datë 27.04.1998 me masë disiplinore “për kryerje pa shkaqe të pranueshme të veprimt, përdorimin e kompetencave e paautorizuar nga dikasteri”**,

duke konsideruar gjetje faktin e largimit nga puna për shkaqe disiplinore me urdhrin nr. 2103 prot, datë 27.04.1998 të Ministrit të Financave, vendosi të njoftojë kandidaten {...} për të dhënë shpjegime, për gjetjen e kësaj procedure në kuptim të nenit 49/2/a në lidhje me pikën “dh” të nenit 28 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

5. Kandidatja, znj. {...}, depozitoi pretendimet e saj lidhur me gjetjen e konstatuar gjatë procedurës së verifikimit duke argumentuar ndër të tjera si më poshtë :

“ Kam filluar marrëdhëniet e punës në Ministrinë e Financave me datë 22 Prill 1997, në pozicionin “specialiste”, pranë Drejtorisë së Legjislacionit, e cila ka zgjatur deri me datë 30 Prill 1998. Kjo eksperiencë ka qenë e para marrëdhënie e vërtetë punësimi pas diplomimit si “juriste” pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në Korrik 1996.

Përgjegjësitë dhe kompetencat e punës si “specialist” pranë Drejtorisë së Legjislacionit përfshinin detyra zbatimi sipas urdhërave të eprorit, pa kompetenca përfaqësimi qoftë të drejtorisë përkatëse apo institucionit .

Fillimi i marrëdhënieve të punës duhet të ketë qenë me emërim, pasi nuk kam patur kontratë të nënshkruar me këtë institucion, por kjo ishte dhe një nga mënyrat e punësimit sipas legjislacionit në fuqi, në të cilin parashikohej (neni 6 Ligji nr. 8095 datë 21.03.1996 “Për shërbimin Civil”) përveç mënyrës së konkurimit, e cila kishte hyrë në fuqi për herë të parë me Ligjin nr. 8095/1996. Unë nuk disponoj asnjë akt emërimi, nuk më është vënë në dispozicion ndonjëherë nga institucioni.

Kam punuar si “specialiste” për rreth një vit, si edhe përmenda më lart ka qenë viti i parë i karrierës sime profesionale pas diplomimit, shumë sfidues në një drejtori, që në atë periudhë kohe ishte shumë e ngarkuar me çështje shumë të rëndësishme dhe delikate me të cilat përballej vendi.

Nuk kam patur asnjëherë komunikim zyrtar, se cili ka qenë shkak i vërtetë i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, por sipas bisedave në ministri dhe Librezë e Punës më është lënë të kuptoj se shkak, ose më saktë pretekst për largimin tim nga detyra u bë një takim pune i zhvilluar në selinë e Bankës Botërore. Pjesëmarrja në takim u bë me një “urdhër verbal” të Drejtorit të Drejtorisë, i cili më urdhëroi të merrja pjesë në takim, pasi duhej një jurist që dinte të komunikonte në anglisht, të dëgjonte se për çfarë ishte takimi dhe të raportonte në lidhje me të.

Unë në këtë takim nuk kam nënshkruar asnjë dokument dhe as kam marrë përsipër ndonjë detyrim këto nuk kanë qenë asnjëherë praktika pune, për aq kohë sa unë kam punuar aty, unë isha në atë takim si në çdo takim tjetër me detyrën e “specialistes” së departamentit. Autorizimi im për pjesëmarrje në këtë takim nuk u formalizua me shkrim nga ana e drejtorit, i cili në momentin e dhënies së urdhërit duhej të më kishte njoftuar edhe për këtë element procedural, nga ana tjetër edhe unë nuk e kam kërkuar pasi unë merrja pjesë nëpër takime në atë kohë jashtë ministrie apo grupe pune dhe nuk më ishte dhënë dhe as komunikuar ndonjëherë se duhej autorizim me shkrim, përveç një rasti të vetëm, gjatë asaj periudhe kohe pune, që ishte përfaqësimi në gjykatë i Ministrisë së Financave.

Në këto kushte pjesëmarrja e ime në atë takim ka qënë me një akt verbal të drejtorit, por pa u konfirmuar shkresërisht nga Kabineti, gjë të cilën unë nuk kisha nga ta dija për shkak të periudhës së shkurtër kohore që u punësova në atë institucion.

Me datë 5 Nëntor 2019 nëpërmjet email Tuaj vihem në dijeni për herë të parë në lidhje me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 2103 Prot., datë 27.04.1998 “Për largimin nga puna”. Në këtë shkresë nuk sqarohet saktësisht se cili konsiderohej si shkak për largimin nga puna dhe nëse unë kisha marrë dijeni apo jo dhe nëse më ishte dhënë mundësia për t’u dëgjuar në lidhje me të.

Ministria e Financave në përpjekje për të referuar një bazë ligjore, i është referuar gabim nenit 32 paragrafi “c”, pasi ky nen nuk parashikon rastet e përfaqësimit të institucionit nga punonjësit e tij në marrëdhëniet me të tretë. Gjithashtu, përfaqësimi, si një institut i së drejtës civile është një veprim juridik që rregullohet me dispozitat e Kodit Civil dhe nuk parashikohet si masë disiplinore në ligjin e referuar nga Ministria e Financave.

Referenca e gabuar ligjore në shkresën e Ministrisë së Financave nr. 2103 Prot., datë 27.04.1998 “Për largimin nga puna” vërteton faktin që kjo shkresë është e pabazuar ligjërisht.

Shprehja “përdorim i kompetencave i paautorizuar”, është e pavërtetë, pasi unë nuk veprava në kundërshtim me kompetencat e vendit të punës, thjesht zbatova një akt verbal urdhër të eprorit direkt, i cili rezultoi se nuk ishte konfirmuar shkresërisht nga kabineti i ministrit. Nuk është se kam marrë ndonjë vendim e paautorizuar, apo të kem nënshkruar në emër të ministrisë pa qënë e autorizuar. Thjesht kam marrë pjesë në një takim pune.

LEGJISLACIONI NË FUQI I KOHËS:

Përgjigjet i gjejmë në legjislacionin në fuqi në atë kohë që ishin ligji dhe VKM në zbatim të tij si më poshtë vijon:

- i) Ligji nr. 8095 datë 21.03.1996 “Për shërbimin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 8300, datë 02.03.1998
- ii) VKM 733 datë 16.09.1996 “Për disiplinën në shërbimin civil”

Çështja që shtrohet është “ a jam pushuar nga puna në Ministrinë e Financave për shkaqe të thyerjes së disiplinës në punë ?”

Përgjigja është shumë e thjeshtë po t’i referohemi legjislacionit të kohës.

Baza ligjore e referuar nga Ministria është **neni 32 paragrafi “c” i ligjit 8095/2016**, i cili parashikonte si më poshtë vijon :

“c) Një veprim i kryer pa shkaqe të pranueshme, i cili është në konflikt me rregullat e etikës së shërbimit civil ose që diskrediton një nëpunës civil ose institucion apo shërbim civil, pavarësisht nëse kryhet brenda ose jashtë zyrës.”

Paragrafi i mësipërm i referohet një veprimi të kryer pa shkaqe të pranueshme, i cili ka të bëjë me rregullat e etikës së shërbimit civil.

Lind pyetja: Ligjvënësi me togfjalëshin “ veprime të kryera pa shkaqe të pranueshme” cilave veprimeve i referohet ?

Për të marrë përgjigje të mëtejshme në lidhje me këtë i referohemi **VKM 733, datë 19.06.1996 “Për disiplinën në shërbimin civil”**, i cili ishte vendimi në fuqi i kohës miratuar në zbatim të ligjit nr. 8095 datë 21.03.1996,

Vendimi parashikon se çfarë kuptohej me shkelje disiplinore sipas pikave të nenit 32 të ligjit dhe në lidhje me shkronjen “c” të nenit 32 të ligjit ky vendim përcakton se:

3. Me "Kryerje e një veprimi pa shkaqe të pranueshme, i cili është në konflikt me rregullat e etikës së shërbimit civil ose që diskrediton një nëpunës civil ose institucion apo shërbim civil, pavarësisht nëse kryhet brenda ose jashtë zyrës" kuptohet:

a) Kryerja, pa shkaqe të pranueshme, e ndonjë veprimi që diskrediton a cënon imazhin e një nëpunësi civil, institucioni të shërbimit civil apo imazhin e nëpunësit dhe shërbimin civil në përgjithësi.

b) Mosrespektimi, pa shkaqe të pranueshme, i detyrave të nëpunësit civil dhe rregullave të etikës së shërbimit civil të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore për etikën në shërbimin civil, në zbatim të këtij ligji.

Është shumë e qartë se kjo dispozitë ligjore nuk i referohet veprimit "përfaqësim i paautorizuar nga dikasteri".

Po t'i referohemi Kodit Civil, se çfarë kuptohet me përfaqësim dhe çfarë parashikohet në rastet e mungesës ose mospasja e një autorizimi përfaqësimi me shkrim në një takim, nëse parashikohet si masë disiplinore në atë kohë mungesa e autorizimit të përfaqësimit. Sipas interpretimit të dispozitave ligjore të Kodit Civil mungesa e dokumentit me shkrim të përfaqësimit do të thotë mungesë përfaqësimi, nuk vijnë pasojat që dëshirohen të arrihen me këtë përfaqësim dhe kjo është pjesë e procedurës dhe ligjshmërisë së veprimeve, por jo shkelje apo thyetje disipline dhe etike në atë kohë. Përfaqësimi pa targa nuk sjell asnjë pasojë për të përfaqësuarin vetëm në rast se ky i fundit i miraton veprimet e përfaqësuesit.

VKM i sipërcituar nuk përmend asnjë masë disiplinore të llojit "përdorim kompetencë e paautorizuar".

"Përdorim kompetencë e paautorizuar" nuk bie në kuptimin dhe përshkrimin sipas ligjit në lidhje me ato që konsiderohen veprime në kundërshtim me etikën po t'i referohemi pikës 2/3 të VKM-së së mësipërme dhe nenit 32 të Ligjit.

Gjithashtu, sipas legjislacionit të kohës mungon një procedurë e rregullt ligjore që të më jetë njoftuar dhe ndjekur.

Si përfundim, në kushtet e një përfaqësimi të paautorizuar, e cili nuk ka sjellë asnjë efekt dhe pasojë për të përfaqësuarin, ky përfaqësim konsiderohet nul. Përfaqësimi nuk është pjesë e rregullave disiplinore.

Shkresa e Ministrisë së Financave është një akt administrativ, i cili nuk shpreh që të jetë bazuar në ndonjë procedurë, njoftim apo vendim i ndonjë komisioni disiplinor, siç parashikonte dhe legjislacioni në fuqi në lidhje me shkeljet disiplinore.

Se çfarë kuptohet me shkelje disiplinore legjislacioni i kohës e ka të parashikuar qartë.

Përse çështja nuk u ndoq gjyqësisht ?

Çështjen nuk e ndoqa gjyqësisht, si edhe e kam shpjeguar më parë, megjithëse mundësitë ishin shumë të mira për ta fituar këtë gjyq, kjo për arsye të thjeshtë:

1) unë isha në fillimet e karrierës sime dhe nuk doja të shikoja mbrapa duke bërë gjyq në atë kohë, pasi e dija që duke bërë gjyq asnjë nga personat që unë mendoja që mund të kishin dashur largimin tim nuk do të cënoheshin nga asnjë vendim gjykate

2) unë vendosa të ecja përpara sidomos kur kohërat ishin të trazura në Shqipëri, e cila nuk po dilte akoma nga një '97 e vështirë;

3) unë fillova punë përsëri në një institucion shtetëror në Ministrinë e Privatizimit në Agjensinë për Zhvillim Ekonomik.

Unë këtë fakt e kam deklaruar që në fillim, dhe e kam analizuar dhe vlerësuar paraprakisht, por tashmë jeni Ju, gjyqtarët, që me gjykimin tuaj dhe besoj se tashmë e keni më të qartë dhe të lehtë marrjen e një vendimi në lidhje me këtë.

Veprimet e Ministrisë së Financave në shkresën janë në kundërshtim me ligjin dhe procedurën. “Veprimi përfaqësim i paautorizuar i dikasterit” nuk përbënte shkelje disiplinore sipas legjislacionit të kohës.”

Sipas nenit 49, pika 2 e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, “Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të nenit 28, të këtij ligji; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit. “

Neni 28 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon ndër të tjera se “Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: **dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;**

Këshilli, në konsideratë të të dhënave të raportuara, të gjetjes së konstatuar, në lidhje me parashikimet ligjore të nenit 49 në lidhje me nenin 28 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se jemi para një prej rasteve të skualifikimit dhe përjashtimit nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë të znj. {...}, për shkak të gjetjes së verifikuar e konkretisht të largimit të saj nga puna për shkaqe disiplinore.

Lidhur me pretendimet e kandidatës për procedurën e largimit të saj nga puna apo për paligjshmërinë e shkakut të këtij largimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vlerëson se nuk është në kompetencën e Këshillit të vlerësojë procedurën e ndjekur nga organi përkatës për largimin nga puna dhe ligjshmërinë e shkakut të largimit, të cilat në çdo eventualitet mund të jenë objekt vlerësimi/shqyrtimi nga gjykata, si organi kompetent në rastin konkret, por në asnjë rast, Këshilli nuk mund të hyjë në analizë të pretendimeve të tilla.

Largimi nga puna për shkaqe disiplinore i znj. {...} nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore, siç ka pohuar dhe vetë kandidatja, e në këto kushte, ekzistenca e këtij shkakut, në kuptim të nenit 49/2/a në lidhje me nenin 28/dh të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përbën shkak skualifikimi dhe përjashtimi të kandidatës, znj. {...}, nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

KONKLUZIONE

1. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se jemi para rastit të skualifikimit dhe përjashtimit të kandidatës znj. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të mosplotësimit prej saj të një prej kriterëve të kandidimit për një pozicion në Gjykatën e Lartë, konkretisht atë të parashikuar në nenin 49/2/a në lidhje me nenin 28/dh të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret nuk është e nevojshme shqyrtimi i rezultateve të verifikimit në lidhje me plotësimin ose jo nga kandidatja të kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, pikërisht të pasurisë dhe të figurës, përsa kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti ose kriteri të vetëm kandidimi pasjell skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136, pikat 3 e 4 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pikat, 1, 2 dhe 5 në lidhje me nenin 32, pika 4, shkronja “c”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “e”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidates jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr.109, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR